Shkoder, me 18.02.2025

# AKT-THEMELIMI I SHOQERISË ME PERGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## BEIZA TRAVEL Sh.P.K

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve themelues të shoqërise me pergjejgesi të Kufizuar **BEIZA TRAVEL Sh.P.K** dhe me emer tregtarë **BEIZA TRAVEL Sh.P.K**

themelohet nga ortaku:

1. **Besmir Shabaj** ,atësia **Mustaf**,amësia **Sabrije** ,shtetas shqipëtar, lindur me **24.07.1986** në **Shkodër**, rezident në Shqipëri dhe banues në adresen : **Rruga e Golemit, Lagja Dobraç,Shkodër** , madhor me zotësi të plotë juridike,për të vepruar ,i identifikuar me anë të letërnjoftimit me **numer 039334215 dhe personal I60724041H** , si dhe nënshtetësi Turke

Në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit Shqipëtar, vendoset të hartohet ky akt - themelimi i shoqerise **BEIZA TRAVEL Sh.P.K** mbi bazën e këtyre principeve:

### NENI 1
### FORMA DHE EMRI

Shoqëria ka formën e Shoqërise me Përgjegjesi të Kufizuar, me iniciale SH.P.K, dhe i përballon humbjet deri në kufirin maksimal të vlerës së kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar.

Emri i shoqerise do të jetë **BEIZA TRAVEL Sh.P.K**

### NENI 2
### BAZA LIGJORE

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007, i ndryshuar " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ,Ligji me Nr.9901, date 14.04.2008 ,I ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ",në perputhje me legjislacionin Shqipëtar në përgjithesi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në perputhje me marrëveshjet ndërkombetare të ratifikuara dhe që do të ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërisë.

### NENI 3
### SELIA

Selia e Shoqërise **BEIZA TRAVEL Sh.P.K** është në adresën: **Rruga e Tiranes, Lagja Berdice e Siperme, Z.Kadastrale 1159, Nr.pasurie 16/11 Shkodër, Shqipëri.**

BESMIR SHABAJ

CamScanner

Në adresën e mesipërme do të identifikohet Qëndra e Përsonit Juridik **BEIZA TRAVEL Sh.P.K**

Me vendim të asamblesë së Ortakëve, mund të hapen degë , filiale ,agjensi ose përfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë sipas fushave në te cilat ushtron veprimtarinë shoqëria.

## NENI 4

## KOHËZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQËRISË

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa - caktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent.

Shoqëria prishet dhe kalon në procedurë likujdimi, sipas rasteve të parashikuar në ligj.

## NENI 5

## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria **BEIZA TRAVEL Sh.P.K** ështe e organizuar në formën e saj juridike si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e cila ka si objekt të aktivitetit :

Agjensi udhëtimi dhe turistike për organizimin e udhëtimeve dhe pushimeve turistike,individuale ose kolektive brenda e jashtë vendit dhe ndermjetësimin për shitjen e produkteve te ketij aktiviteti.
Shërbime që lidhen me udhëtimet, pushimet ,pritjen e turisteve, trajtimin e tyre në njesite akomoduese, me ushqim në bar restorante, vizitat në objektet historiko - kulturore dhe transportin me mjetet e shoqërisë ose të treteve. Tour Operator,Transport udhetarësh dhe mallrash për vete dhe të tretë brenda dhe jashte vendit. Transportin e udhëtareve ne linja të rregullta me autobuz.Transferta nga aeroportet ne destinacionet perkatese si brenda dhe jashte vendit (Tirane – Dubrovnik – Tirane dhe te jera).
Konsulence ne fusha te ndryshme, mundesi ndermjetesim biznesi si Brenda dhe jashte vendit. Import, eksport I produkteve te ndryshme ne fushen e tekstilit dhe makinerive te industrise ushqimore, Aktivitet ne fushen e ndertimit, dhe arkitektures. Aktivitete imobiliare ne ndermjetesimin sipas kerkesave te klienteve.

## NENI 6

## KAPITALI THEMELTARË

Kapitali themeltarë i Shoqerisë **BEIZA TRAVEL Sh.P.K** është 2.100.000 leke (Dy million e njeqind mije lekë), i ndarë në 1 (nje) kuota ( pjesë ) .

Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga:

1- **Besmir Shabaj me 100% të kuotave me vlerë 2,100,000 LEKË**

BESMIR SHABAJ

CamScanner

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyhet tëresisht dhe depozitohet në nje llogari të hapur në emër të shoqërisë në nje nga bankat e nivelit te dyte.

## NENI 7

## AKTET E SHOQËRISË

Shoqëria do të rregullohet, perveç këtij akt-themelimi dhe me norma të përcaktuara në statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortaku i shoqërisë dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person Juridik në Republikën e Shqipërisë.

## NENI 8

## ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqerisë do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe Administratori. Shoqeria mund të emërojë me shume se një administrator.

Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e Shoqerise **BEIZA TRAVEL Sh.P.K,** ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer.

Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese.Në aktet e krijimit të ketyre organeve do të përcaktohen kohëzgjatja dhe kompetencat e tyre.

Administratori i shoqërise për nje periudhe 5 (pese) vjecare është Z. Besmir Shabaj I identifikuar me numër përsonal **I60724041H.**

## NENI 9

## DISPOZITA E FUNDIT

Çdo mos-marrëveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortaket do ta zgjidhin me mirekuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet ,kompetente për gjykimin e mos - marrëveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kompetent .

Ky akt themelim ështe hartuar në 2 (dy) kopje, në gjuhën shqipe duke patur secila kopje fuqi të njëjte ligjore.

**ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISE**

**BEIZA TRAVEL Sh.P.K**

BESMIR SHABAJ

Z. Besmir Shabaj ______________

CamScanner